



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:204387

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05683875

C.nr.416/17

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA E GJYKATËS MALISHEVË-
Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil**, me gjyqtaren Hatixhe Begaj, në çështjen kontestimore të paditësit: Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a K. – P., kundër të paditurit: A. B. B. nga fshati B., Komuna e Malishevës, më objekt kontesti “*kompensimi i demit material*”, gjykata pas shqyrtimit kryesor, me datë 14.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET kërkesa e ekspertit financiar D.S. nga F. K., i cili ka kërkuar që në emër të shpenzimeve për ekspertizën e punuar të datës 05.04.2024 për lëndën C.nr.416/17, për gjykatën të paguhet vlera prej 150.00 euro, ku **URDHEROHET** Arka e kësaj gjykate që të bëjë pagesën në numrin e llogarisë bankarenë R. B..

A r s y e t i m

Gjykata ka caktuar ekspertin e lartcekur sipas aktvendimit C.nr.416/17 të datës 25.03.2024, ndërsa sipas aktvendimit si ne procesverbalin e datës 19.03.2024, ka obliguar palën e paditur që të deponoj shumën prej 150.00 euro për pagesën e shumës për ekspertizë. Pala e paditur me datë 20.03.2024, ka deponuar shumën prej 150.00 euro, ndërsa eksperti në gjykatë ka dorëzuar ekspertizën me datë 05.04.2025.

Andaj për faktin se tani më lënda ka përfunduar me aktvendim, ku eksperti e ka dorëzuar ekspertizën së bashku me faturën, i njëjti ka kërkuar që pagesa për ekspertizën të bëhet në shumën prej 150.00 euro (njëqind e pesëdhjetë euro).

Andaj, **URDHEROHET** K. në P. – A. e kësaj gjykate që të veprojë si në dispozitiv të këtij Aktvendimi që shuma e mjeteve prej 150.00€ të paguhet ne llogarinë bankare të ekspertit.

Me sa u tha me lartë u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA MALISHEVË
C.nr.416/17 datë 14.05.2024**

**Gjyqtarja
Hatixhe Begaj**

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 387 paragraf 2 të LPK-së.